



Datë: 05.08.2025
Numër Protokolli: 5480/2025

A.nr.1184/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi Bajraktari, kryetare, Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj Demi, anëtarë, me Atdhe Gashi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurës sipas ankesës me numër A.nr.1184/2025, të datës 20.06.2025, të parashtruar nga ankuesi E.S kundër organit të punësimit: Komunës së Drenasit, në çështjen juridike “*shkelje e të drejtës në pagë*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, nenin 16, paragrafi 3 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 05.08.2025, me shumicë vota, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e parakohshme ankesa me numër A.nr.1184/2025, e datës 20.06.2025, e parashtruar nga ankuesi E.S.

A r s y e t i m

Nëpunësi civil, E.S (*tutje referuar vetëm ankuesi*), më datë 20.06.2025 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, për shkak të mos përfshirjes në kategorizimin e pagave sipas Rregullores Nr.06/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil dhe Vendimit Nr.08/224 të datës 23.10.2024, të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli*) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 10.07.2025 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Komuna e Drenasit, ndërsa kjo e fundit më datë 15.07.2025 ka përcjellë përgjigje në ankesë, së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji i Këshillit nga analizimi i shkresave të lëndës si dhe referuar pretendimeve ankimore të parashtruara nga ankuesit, ka gjetur se ankesa **është e parakohshme**, sepse:

Nga administrimi i shkresave të lëndës rrjedhë së ankuesi sipas Akt Emërimit me shifër AE.Nr.01-112/03-21866 të datës 18.05.2022, është i punësuar në pozitën e punës Zyrtar për Gjendje Civile në Sektorin e Gjendjes Civile të Komunës së Drenasit.

Tutje ankuesi më datë 27.05.2025, ka parashtruar një kërkesë tek Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore e Komunës së Drenasit, me të cilën ka kërkuar ndryshimin e akt emërimit përkatësisht nga Klasa Profesional 3, në koeficient 4.44 në Klasën Profesional 2 me koeficient të pagës 5.45, sipas Rregullores Nr.06/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil dhe Vendimit Nr.08/224 të datës 23.10.2024, të Qeverisë së Republikës së Kosovës, me të cilin është miratuar Katalogu i Vendeve të Punës për Shërbimin Civil.

Ndërsa, Udhëheqësi i Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Komunën e Drenasit, përmes përgjigjes së datës 02.06.2025, ka njoftuar ankuesin Komuna e Drenasit ende nuk e ka përfunduar klasifikimin e vendeve të punës për nëpunësit civil në kuadër të këtij institucioni, mirëpo për këtë çështje Kryetari i Komunës ka nxjerrë Vendimin me Nr.01-030/01-12144 të datës 08.03.2025, për formimin e grupit punues për hartimin e draft Rregullores për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës të Shërbimit Civil në Komunën e Drenasit, duke theksuar se ankesa e ankuesit në këtë fazë është e parakohshme dhe si e tillë nuk i plotëson kushtet ligjore për trajtim meritore.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon së po i mohohet e drejta për të realizuar koeficientin sipas klasës profesionale 2, të përcaktuar për këtë pozitë pune sipas katalogut të vendeve të punës në shërbimin civil, andaj kërkon nga Këshilli rishikimin dhe korrigjimin e kategorizimit në Klasën Profesionale 2, me koeficient të pagës 5.45, në përputhje me Rregulloren dhe Vendimin përkatës, si dhe përlogaritjen dhe pagesën e mjeteve të munguara, duke përfshirë diferencën e pagës që nga momenti i hyrjes në fuqi të Rregullores.

Lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore të ankuesit, Kolegji i Këshillit analizoi dispozitat e Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, i zbatueshëm nga data 05.02.2023, përkatësisht nenin 2, paragrafi 1, në lidhje me fushëveprimin ku parashihet se: ”1. Ky ligj zbatohet për të punësuarat/it në sektorin publik pagat e të cilave/ëve financohen nga dhe përmes buxhetit të shtetit, 2. Rregullat dhe kushtet për përcaktimin e pagës të të punësuarave/ëve në sektorin publik janë ekskluzivisht rregullim i këtij ligji dhe mund të rregullohen edhe me akte të tjera nënligjore, vetëm kur parashihet shprehimisht nga ky ligj”, dhe nenin 14, paragrafi 3, të këtij ligji ku përcaktohet se: 3. Klasifikimi i një pozite të caktuar të shërbimit civil, bëhet në bazë të rregullave të vlerësimit dhe klasifikimit të pozitave të punës, sipas dispozitave për klasifikimin e pozitave të shërbimit civil, në pajtim me legjislacionin në fuqi për zyrtarët publik, dhe rrjedhimisht, referuar këtij përcaktimi ligjor, Kolegji i Këshillit konstatoi se paga bazë e nëpunësit civil përcaktohet sipas klasës së pagës, përkatësisht koeficientit, të cilit i përket pozita e punës, e klasifikuar në shtojcën Nr.10 të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, ndërsa klasifikimi i një pozite të caktuar të shërbimit civil, bëhet në pajtim me legjislacionin në fuqi për zyrtarët publik dhe rregulloren e aplikueshme për klasifikimin e vendeve të punës në Shërbimin Civil.

Kolegji i Këshillit, nga analizimi i shkresave të lëndës, ka gjetur se organi i punësimit, gjegjësisht Komuna e Drenasit, deri në parashtrimin e ankesës nga ana e ankuesit nuk e kishte përfunduar procesin e klasifikimit të vendeve të punës për nëpunësit civil në kuadër të këtij institucioni, dhe se procedimi i pozitës së ankuesit në sistemin e ri të pagave, të krijuar sipas Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, nuk është si pasojë e klasifikimit të pozitës së tij të punës, në kuptim të ligjit material, gjegjësisht Ligjit përkatës për Zyrtarët Publikë dhe Rregullores përkatëse për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, por si rezultat i zbatimit të Vendimit Nr.04/128 të datës 16.02.2023, të Qeverisë së Kosovës lidhur me ekuivalencën e sistemit të vjetër me sistemin e ri të klasifikimit të koeficienteve me qëllim të llogaritjes së pagës bazë dhe duke qenë se nuk kishte përfunduar klasifikimin e vendeve të punës sikurse përcaktohet me dispozitat e Rregullores (QRK) Nr.06/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, e aplikueshme nga data 28.02.2024, rrjedhimisht me nenin 34 të kësaj rregullore përcaktohet se: ***Obligohen institucionet në fushën e veprimit të kësaj Rregulloreje të përgatisin klasifikimin dhe grupimin e pozitave të punës në pajtim me këtë Rregullore dhe katalogun e vendeve të punës, jo më vonë se tre (3) muaj nga hyrja në fuqi e kësaj Rregulloreje***, dhe po ashtu, edhe me Vendimin me Nr.08/226, të datës 23.10.2024, të Qeverisë së Republikës së Kosovës për miratimin e Katalogut të Vendeve të Punës për Shërbimin Civil, më pikën 2 të këtij vendimi është përcaktuar se: ***Obligohen të gjitha institucionet që të përfundojnë Klasifikimin e vendeve të punës në përputhje me Rregulloren Nr. 06/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës dhe këtë katalog***, ndërsa, më pikën 3 është shfuqizuar pika 3 dhe 4, e Vendimit Nr. 04/128, të datës 16 shkurt 2023 të Qeverisë së Kosovës, pika këto që i referoheshin detyrimit të Ministrisë së Financave/Thesarit të Kosovës dhe Ministrisë së Punëve

të Brendshme/Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik për ekuivalentim të koeficienteve dhe korrigjimeve.

Mirëpo duke marr parasysh faktin se sipas përgjigjes në kërkesë të datës 15.07.2025 të Udhëheqësit të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të Komunës së Drenasit, kjo komunë është në fazën e miratimit të Rregullores për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës, rrjedhimisht duke qenë së organi përkatës i punësimit në këtë rast Komuna e Drenasit, është në fazën e procesit të klasifikimit të vendeve të punës në administratën komunale e që nënkupton edhe klasifikimin edhe të pozitës së ankuesit, atëherë Kolegji i Këshillit vlerëson se ankesa e parashtruar nga ankuesi, për klasifikimin e pozitës së tij sipas kategorisë profesionale 2, është e parakohshme, dhe si e tillë, në këtë fazë nuk i plotëson kushtet ligjore për trajtim meritore, e për rrjedhojë, e njëjta është e papranueshme në kuptim të nenit 129 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Theksuar si me sipër, Kolegji i Këshillit, vlerëson se vetëm pas përfundimit të procesit të klasifikimit të pozitave të punës nga organi përkatës i punësimit, sipas procedurës se theksuar më lart, ankuesit do t'i lindë e drejta e kundërshtimit dhe ankesës për klasifikimin e pozitës së tij të punës.

Kështu që, në mbështetje të nenit 18, paragrafi 1, nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë—Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.1184/2025

Atdhe GASHI

Procesmbajtës

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit E.S;
- Udhëheqësit të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Komunën e Drenasit; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.